REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 28, datë 29.09.2008

PËR "MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE"

Në mbështetje të ligjit nr. 8652, dt 31.07.2000 për "Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"; neni 32, gërma "ç"; të "Kodit të Proçedurave administrative", neni 121, pika 1, neni 124, pika 1; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.551, datë 7.11.2002 për "Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", pika 14; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.63, datë 06.12.2007, "Për disa shesa dhe ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të institucioneve të vartësisë"; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 5, datë 27.02.2003 për "Miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore" me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore me një numër prej 130 punonjësish, sipas Aneksit nr. 1, bashkëngjitur këtij Vendimi.

2. Në mbështetje të pikës 1 të këtij vendimi, të miratohet niveli i pagës për çdo funksion të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore sipas Lidhjes nr. 1, bashkëngjitur këtij vendimi

3. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 5, datë 27.02.2003 për "Miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore" revokohet, ndërsa vendimi i Këshillit Bashkiak nr 63, datë 06.12.2007 për "Disa ndryshime në nivelin e pagave të punonjësve të institucioneve të vartësisë", revokohet për pikën 1.

4. Efektet financiare të këtij vendimi do të fillojnë nga data 15.10.2008 dhe do të mbulohen duke pakësuar buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme te Taksave dhe Tarifave Vendore në shumën 3.550.000 lekë në artikullin

(602) shpenzime operative, dhe duke shtuar buxhetin e ketij institucioni në paga (Art 600) 3.000.000 lekë; sigurime shoqërore 550.000 lekë.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetese dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R

Lidhja Nr.1
Niveli i pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithëshme të Taksave dhe Tarifave Vendore

		Paga individuale			Paga mujore	
Nr.	**Pozicioni**	**Kategoria**	**Grupi**	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për pozicion**	**Shtesa për kushte pune**
			1	**2**	**3**	**4**
1	Drejtor i Pergjithshem	**II-a**	1	2%	80000	10000
2	Drejtor Drejtorie	**II-b**	1	2%	67000	7000
3	Pergjegjes sektori	**III-a**	1	2%	54000	6000
4	Pergjegjes zyre	**III-b**	1	2%	40000	6000
5	Specialist I	**III-b**	1	2%	40000	5000
6	Specialist II	**IV-a**	1/2	2%	30000	4000
7	Specialist mesem	**IV-b**	1/2	2%	20000	2000
8	Magazinier	**IV-c**	2	2%	17000	
9	Shofer				25000	
10	Punetor mirembajtje, pastrimi				24000	

Shtesa për vjetërsi në punë për **Lidhjen Nr.1 të jepet në masën 2%** pas çdo viti pune, **deri në 25 vjet**, dhe të llogaritet mbi **pagën e grupit**.

Paga e grupit është si në tabelë:

Grupi	Diploma	Paga në lekë
1	**Diplomë e shkollës së lartë**	**10 050**
2	**Diplomë e shkollës së mesme**	**7 000**

ANEKSI NR.1,STRUKTURA E DETAJUAR SIPAS FUNKSIONEVE

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE	**DREJTOR I PERGJITHSHEM**	**DREJTOR**	**PERGJEGJES SEKTORI**	**PERGJEGJES ZYRE**	**SPECIALIST 1-RE**	**SPECIALIST I 2-TE**	**SPECIALSISTE**	**PUNONJES MBESHTETES**
130	**1**	**2**	**10**	**4**	**55**	**42**	**6**	**10**
Drejtor i Pergjithshem	**1**							
Sekretar							**1**	
Sektori i asistences dhe rregjistrimit te taksapaguesve			**1**		**6**	**2**		
Sektori i kontrollit te brendhshem dhe investigimit			**1**		**2**			
Sektori I Shërbimit Informatik			**1**		**2**			
Sektori Juridik dhe Menaxhimi i Apelimeve			**1**		**2**			
Drejtoria operacionale e Taksave dhe Tarifave								
Drejtori		**1**						
Sektori i mbledhjes			**1**		**10**			
Sektori i verifikimit ne terren			**1**		**10**	**30**	**4**	
Sektorit te kontrollit tatimor dhe analizes se riskut			**1**		**11**			
Zyra e parkimit te automjeteve dhe kundravajteve				**1**		**8**		
Drejtoria e Administrimit Teknik dhe Financiar								
Drejtori		**1**						
Zyra e Statistikës dhe Raportimit				**1**				
Sektori i Përpunimit, Vlerësimit dhe Kontabilizimit të të Ardhurave			**1**		**3**	**1**		
Sektori i Menaxhimit të Borxhit dhe Kontrollit të Agjentëve Tatimor			**1**		**9**			
Sektori i Administratës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve			**1**					**8**
Zyra e Finances				**1**		**1**		**2**
Zyra e Protokollit				**1**			**1**	